

Drejtoria / Struktura dhe Detyrat funksionale

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut ka si mision kryesor ruajtjen dhe rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg sipas përcaktimeve të ligjit Nr 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij .

Qëllimi i punës së Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut është që nëpërmjet zbatimit të procedurave hetimore të parashikuara në ligj në bashkëpunim me drejtoritë/sectorët e tjerë të Autoritetit, të mbikëqyre tregun dhe te propozojë masat e duhura për rivendosjen e konkurrencës në rastet e pengimit, kufizimit apo shtrembërimit të konkurrencës në treg.

Misionin e saj Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut e realizon nëpërmjet zbatimit të ligjit dhe e mbështetur nga kuadri ligjor dhe rregullator, kryesisht nëpërmjet propozimit për ndalimin e marrëveshjeve të ndaluara, ndalimit të abuzimit me pozitën dominuese të një/disa ndërmarrjeve dhe procedurave të kontrollit të përqendrimeve.

"Pozitë dominuese" është pozita e një ose më shumë ndërmarrjeve, që i lejon ato të jenë të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si: konkurrentët, klientët ose konsumatorët. Sektori i Pozitës dominuese merret me shqyrtimin e ndërmarrjeve që kanë një pozite dominuese në treg.

"Marrëveshje" janë marrëveshjet e çdo forme, të lidhura ndërmjet ndërmarrjeve, me ose pa forcë detyruese, vendimet ose rekomandimet e grupimeve të ndërmarrjeve, si dhe praktikat e bashkërenduara ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat veprojnë në të njëjtin nivel, pra marrëveshje horizontale ose në nivele të ndryshme, pra marrëveshje vertikale, të tregut. Sektori Anti-kartel merret me shqyrtimin e marrëveshjeve të ndaluara.

Përqendrimet e ndërmarrjeve kemi në rastet kur shkaktohet një ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit si rrjedhojë e:

Bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra –tjetra;

Përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrje, mbi një ose më shumë ndërmarrje ose pjesë të këtyre të fundit, përmes blerjes së aksioneve, kuotave ose aseteve , kontratës ose çdo mjeti të ligjshëm;

Kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjese të këtyre të fundit;

Krijimit të një ndërmarrje të përbashkët e cila nuk ka si objekt apo pasojë bashkërendimin e veprimtarive konkurruese ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjesh të pavarura”.

Drejtoria Juridike , Hetimit dhe Procedurave

Vlerësimi i akteve ligjore dhe nënligjore ne fuqi lidhur me përputhshmërinë me ligjin dhe shkallen e kufizimit ose te pengimit te konkurrencës, duke synuar përafrimin e legjislacionit vendas me “*Acquis Communautaire*”, institucionet e tjera qendrore dhe vendore ne fushën e konkurrencës.

Zbatimi i politikave ekzistuese si dhe përshtatjen e politikave te reja ne fushën e hartimit te legjislacionit ne sferën e konkurrencës.

Ndjekjen e procedurave te proceseve gjyqësore dhe hartimin e materialeve juridike te këtyre procedurave, ne te cilat Autoriteti i Konkurrencës është pale ndërgjyqësore ne bashkëpunim me drejtoritë e tjera te Institucionit.

Dhënien e ndihmës se nevojshme profesionale, ne bashkëpunim me kabinetin për hartimin dhe redaktimin e akteve juridike te Autoritetit dhe Komisionit ne veçanti sa here qe kërkohet nga ky i fundit.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Integritit Evropian

Te siguroje qe funksionet te cilat kane te bëjnë me personelin, ofrojnë shërbime eficiente, qe plotësojnë kërkesat e institucionit lidhur me stafin dhe inkurajojnë zhvillimin e personelit dhe realizimin e detyrave prej tyre, ne përputhje me kërkesat dhe rregullat e vendosura te shërbimit civil, për menaxhimin e burimeve njerëzore.

Te monitoroje zbatimin e te gjitha politikave te personelit qe përmbledhin plotësimin e kërkesave, vlerësimin dhe klasifikimin e punëve, rekrutimin dhe seleksionimin, vlerësimin e rezultateve ne pune, pagesën, trajnimin dhe zhvillimin individual, disiplinën dhe procedurat e marrëdhënieve midis nëpunësve ne institucion.

Te planifikoje dhe menaxhoje buxhetin e institucionit duke patur parasysh plotësimin e kërkesave te nëpunësve si dhe vlerën e parasë.

Te siguroje ne çdo hap plotësimin e kërkesave te ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe aktet nënligjore ne zbatim të tij, Kodit te Punës si dhe ligje te tjera specifike qe ndikojnë ne punësim.

Përgjigjet për hartimin e legjislacionit ne përputhje me legjislacionin ne fuqi duke

synuar përaftrim me legjislacionin Evropian.

Qëndron ne kontakt te vazhdueshëm me faqen zyrtare te Komisionit Evropian dhe kuadrin e ri legjislativ te tij ne fushën e konkurrencës .

Respekton afatet ne aderimin e objektivave te vendosura

Jep mendime e sugjerime dhe kontributin e saj sa here qe kërkohet nga strukturat përbërëse te Autoritetit si dhe i përgjigjet korrespondencës me jashtë institucionin dhe respekton hierarkinë

Harton projekt-rregullore dhe udhëzime ne lidhje me tre shtyllat e ligjit për konkurrencën dhe procedurat përkatëse qe duhen ndjekur ne respektim te ligjit.

Merr pjesë në grupet e punës të ngritura me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm për monitorimin, studimin dhe hetimin e përgjithshëm ose të veçantë të tregjeve në rastet e praktikave anti-konkurrese.

Sektori i Analizës dhe Studimeve

Vëzhgimi i kushteve te tregut për zhvillimin e konkurrencës se lire dhe efektive ne Shqipëri. Përgatitja e studimeve dhe dhënia e rekomandimeve përkatëse, ne zbatim te ligjit nr.9121, date 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës " dhe aktet nënligjore ne zbatim te tij.

Mbledhje periodike e informacionit si një funksion i vazhdueshëm me qellim krijimin e bazës për vlerësimin e kushteve te tregut përkatës, për te asistuar ne kohe ne vendimmarrje.

Zhvillimi dhe vlerësimi i metodave dhe procedurave për mbledhjen e te dhënave siç janë pyetësorët, anketimet apo koordinimi i mënyrave te tjera për marrjen e informacionit.

Vlerësimi i te dhënave te grumbulluara mbi tregun përkatës ne monitorim me qellim identifikimin e cenimit te mundshëm te konkurrencës.

Ne bashkëpunim me sektorët e tjerë te sekretariatit administron te dhënat ne funksion te krijimit te databazes dhe një sistemi paralajmërues te elementeve te kufizimit te konkurrencës